Republika e Shqiperise

Komisioni i Letrave me Vlere

Raporti Vjetor

2003

Annual Report

Albanian Securities Commission

Republika e Shqiperise

Komisioni i Letrave me Vlere

RAPORTI VJETOR

2003

Permbajtja e Lendes

Ngjarje Kryesore **3**
Informacion i Pergjithshem mbi Komisionin e Letrave me Vlere **4**
Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere **7**

1. Legjislacioni **8**

2. Aktiviteti i Licensimit, Monitorimit dhe Disiplinimit **10**
2.1 Licensimi i Subjekteve 10
2.2 Licensimi i Tregut 11
2.3 Monitorimi i Burses se Tiranes sh.a 11
2.4 Monitorimi i Qendres per regjistrimin e Aksioneve sh.a 12
2.5 Monitorimi I subjekteve te licensuara 12
2.6 Disiplinimi 13

3. Bashkepunimi Nderkombetar **14**
3.1 Bashkepunimi me IOSCOn 14
3.2 Bashkepunimi me Komisionet Analoge dhe Institucionet e tjera 15
3.3 Marreveshjet e Mirekuptimit 16
3.4 Asistenca Teknike 16
3.5 Pjesemarrja e KLV ne Seminare, Konferenca e Programe Trainimi
3.6 Aktiviteti Publikues 17

4. Zhvillimi i Tregut gjate vitit 2003 **19**

5. Plani i Aktiviteteve te Komisionit te Letrave me Vlere per 2004 **21**

6. Buxheti i KLV ne vitin 2003 **22**

7. Shtojca **24**

NGJARJA KRYESORE E VITIT 2003

KOMISIONI I LETRAVE ME VLERE, NE MBLEDHJEN E DATES 1.07.2003, VENDOSI DHENIEN E LICENSES PERFUNDIMTARE SHOQERISE BURSA E TIRANES sh.a PËR TE OPERUAR SI TREG LETRASH ME VLERE

Informacion i Pergjithshem mbi Komisionin e Letrave me Vlere

Komisioni i Letrave me Vlere (KLV) i Republikes se Shqiperise, eshte krijuar ne baze te Ligjit nr. 8080, date 1.3.1996 "Per Letrat me Vlere", ndjekur nga Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 696, date 14.10.1996. KLV eshte autoriteti i vetem rregullator i Tregut te Letrave me Vlere qe zhvillon veprimtarine e tij ne territorin e Shqiperise.

Perberja e Komisionit

Fatos Reca	Kryetar
Rexhina Nano	Nen Kryetare
Adrian Fullani	Komisioner
Elisabeta Gjoni	Komisionere
Keler Gjika	Komisioner
Manjola Naco	Komisionere
Marjan Gjermeni	Komisioner

Komisioni perbehet nga shtate Komisionere te cilet emerohen me propozim te Presidentit te Republikes dhe me miratim te Kuvendit Populllor. Komisioni mblidhet ne takime te rregullta, ku merren vendime, percaktohen prioritete, diskutohet per programet ne vazhdimesi dhe ato te perspektives.

Komisioni financohet nga Buxheti i Shtetit me subvencion per nje periudhe kohe derisa te funksionoje si institucion i pavarur ku pagimi i kuotave dhe detyrimeve te tjera ndaj Komisionit do te jene te mjaftueshme per funksionimin e tij.

Misioni i Komisionit te Letrave me Vlere

- Te siguroje standarte te larta per mbrojtjen e investitoreve ne letrat me vlere
- Te nxise besueshmerine ne eficencen e tregut te letrave me vlere ne Shqiperi, ne menyre qe te mbeshtese zhvillimin e tij te vazhdueshem
- Te gjeje balancen e pershtatshme midis masave, qe sigurojne mbrojtjen e investitoreve dhe masave, qe inkurajojne zhvillimin dhe modernizimin e tregut
- Te mbikqyre efektivisht aktivitetet e tregjeve te letrave me vlere, institucionet qe kryejne pastrimin dhe rregullimin e llogarive dhe aktivitetin e pjesemarresve te tregut

Funksionet e Komisionit te Letrave me Vlere jane si vijon:

- licenson, vezhgon dhe mbikqyr veprimtarite e tregjeve te letrave me vlere, si dhe te ofruesve per pastrimin e llogarive dhe rregullimin e transaksioneve te letrave me vlere ne llogarite perkatese;
- licencon, mbikqyr dhe vezhgon veprimtarite e tregetareve te licensuar, keshilltareve te investimeve, perfaqesuesve te tyre perkates dhe drejtuesve te licensuar te investimeve;
- miraton statutin dhe rregulloren e shoqerive te licensuara per te vene ne veprim nje treg te letrave me vlere, ofruesve te sherbimeve per pastrimin e llogarive dhe rregullimin e transaksioneve te letrave me vlere si dhe te depozituesve;
- vezhgon dhe vendos rregullat per drejtimin e te licensuarve, duke perfshire revokimin dhe pezullimin e licensave;
- nxit dhe inkurajon standarte te larta per mbrojtjen e investitoreve dhe integritetit ndermjet te licensuarve;
- mbeshtet funksionimin e tregjeve te letrave me vlere ne menyre te rregullt, te hapur dhe te informuar sic duhet;
- ndermerr te gjithe hapat e nevojshem per te mbrojtur interesat e investitoreve dhe ndalon veprimet e paligjshme, te pandershme dhe te papershtatshme lidhur me tregtimin e letrave me vlere;
- ushtron dhe permbush te drejta dhe detyra te tilla qe i akordohen apo vendosen mbi te;
- miraton, ndryshon, pezullon dhe shfuqizon rregulla dhe urdhra te tille sic autorizohen, ose si te pershtatshme per t'u plotesuar nga ky ligj dhe mund te percaktoje termat e perdorura ne kete ligj ne menyre qe te perputhen me aktet e tij. Ai ndermerr te gjithe hapat e nevojshem per te siguruar perputhjen e ketij ligji me cdo rregull te vendosur ne baze te tij;
- mbikqyr menyren e tregtimit dhe llojin e letrave me vlere qe tregtohen ne tregun perkates dhe miraton rregullat e tregjeve te letrave me vlere lidhur me anetaresine, listimin, pjesmarrjen minimale, mjaftueshmerine e kapitalit, shpalljet, raportimet periodike, raportimet per te gjithe transaksionet si dhe pastrimin e llogarive dhe rregullimin e transaksioneve.

Per permbushjen e misionit te ngarkuar me ligj, KLV ka ngritur administraten e tij, e cila eshte e detyruar te zbatoje te gjitha vendimet e marra dhe detyrat e caktuara ne mbledhjet e Komisionit. Organet drejtuese te administrates se Komisionit jane Bordi i Komisionereve dhe Drejtori Ekzekutiv i Administrates se KLV.

Komisioni ndjek nje politike punesimi te kujdesshme e te qendrueshme. Kjo behet permes zgjedhjes se personelit bazuar ne cilesite profesionale, kualifikimeve dhe eksperiences se tyre.

Struktura Organizative e Komisionit te Letrave me Vlere



1. Legjislacioni

Plotesimi dhe permiresimi i kuadrit ligjor te tregut te letrave me vlere ne perputhje me standartet nderkombetare, ka qene fokusi kryesor i aktivitetit te KLV. Ne mbeshtetje te ketij objektivi kane sherbyer parimet e IOSCOs, Direktivat e Komunitetit Evropian dhe eksperienca e tregjeve me te zhvilluara te letrave me vlere.
Gjate vitit 2003 zhvillimet ne legjislacion për tregun shqiptar te kapitaleve konsistojne ne vendimet e rendesishme te Komisionit për miratimin e draft rregulloreve lidhur me funksionimin e tregut te letrave me vlere.
Si arritje kryesore ne fushen e legjislacionit për tregun e letrave me vlere gjate ketij viti, mund te permendim:

Ne 7 Shkurt 2003, Komisioni aprovoi Rregulloren "*Mbi Licensimin e tregtarit te Letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij*". Nga Rregullorja ekzistuese qe mbulonte ne menyre integrale procedurat per licensimin e gjithe operatoreve te tregut te kapitaleve, rregullorja e licensimit te tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij u perqendrua pikerisht ne kete segment te operatoreve. Ky eshte rezultat i stadit te ri te zhvillimeve ne Shqiperi ne lidhje me tregun e letrave me vlere si rrjedhoje e shkeputjes se Burses se Tiranes nga Banka e Shqiperise dhe dalja e saj si shoqeri aksionere. Kjo rregullore paraqet ne nje format te detajuar kerkesat per licensim si tregtar dhe perfaqesues, te drejtat dhe detyrimet e aplikuesit, proceduren e aplikimit nga momenti i dorezimit te dokumentacionit te aplikimit per license deri ne dhenien ose refuzimin e saj.

Per kuptimin me te mire te legjislacionit lidhur me tregun dhe tregtaret e licensuar te letrave me vlere Komisioni ka pergatitur dhe botuar ne maj 2003 nje komentar qe fokusohet mbi dy Rregulloret e miratuara prej tij lidhur me licensimin e tregut te letrave me vlere, tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij.

Ne korrik 2003, Komisioni vendosi t'I beje nje amendim rregullores se lartpermendur. Ky amendim konsiston ne obligimin e tregtareve te letrave me vlere per te informuar periodikisht Komisionin mbi aktivitetin e tij.

Ne 8 Shtator 2003, Komisioni mori vendim *per harmonizimin e disa kerkesave dhe detyrimeve te rregulloreve ekzistuese mbi licensimin e subjekteve*. Rregulloret qe u preken nga ky ndryshim jane rregullorja nr.2/2 date 7.2.2003 "*Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij*", Rregullorja nr.9/1 date 30.10.2001 "*Mbi licensimin e rregjistruesve te letrave me vlere*" dhe Rregullorja nr.6/1 date 17.06.2002 "*Mbi licensimin e tregut te letrave me vlere*". Vendimi perfshin te gjitha subjektet e licensuara dhe konsiston ne unifikimin e detyrimeve sic jane, miratimi i statutit te shoqerive (te cilat kerkojne te operojne si treg letrash me vlere dhe rregjistrues); kerkesat per drejtuesin e shoqerise; detyrimin per informim prane Komisionit; kuotat dhe komisionet; perjashtimin nga pagimi apo rimbursimi i kuotes per rastet e jashtezakonshme.

Vendimet e KLV gjate 2003

- Vendimi nr. 1/3 dt 16.1.2003 "Mbi ndryshimet ne Rregulloren nr.5/1 dt 29.6.1999 Per strukturen organizative dhe ndarjen e kompetencave ne administraten e KLV".
- Vendimi nr. 2/2 date 7.2.2003 mbi miratimin e Rregullores "Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij."
- Vendimi nr. 6/2 date 27.5.2003 mbi ndryshimet ne Rregulloren nr. 9/1 date 30.10.2001 "Mbi licensimin e rregjistruesve te letrave me vlere".
- Vendimi nr. 6/3 dt 27.5.2003 mbi ndryshimet ne Rregulloren nr. 2/3 dt 5.2.2002 "Mbi organizimin e provimit te individeve qe kerkojne te pajisen me license si perfaqesues tregtari".
- Vendimi nr. 8/2 dt 1.7.2003 mbi ndryshimet ne Rregulloren nr. 2/2 dt 7.2.2003 "Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij."
- Vendimi nr. 9/2 dt 8.9.2003 "Mbi unifikimin e rregulloreve per licensimin e tregut, te tregtarit dhe te rregjistruesve"
- Vendimi nr. 10/4 dt 29.10.2003 mbi miratimin e "Te drejtes se perparesise ne nenshkrim" si leter me vlere.
- Vendimi nr. 12/2 dt 29.12.2003 mbi disa shtesa ne Rregulloren nr. 2/2 dt 7.2.2003 "Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij" ne lidhje me kerkesat baze per kontraten broker-klient.

Ne Dhjetor 2003, Komisioni mori vendim për nje ndryshim te ri ne rregulloren *"Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij"* per perfshirjen e nje aneksi shtese ne kete rregullore ne lidhje me kerkesat baze per kontraten broker-klient. Qellimi i ketij aneksi eshte rregullimi ne parim i marredhenieve broker - klient ne procesin e ofrimit te sherbimit te tregtimit te letrave me vlere ne emer dhe per interes te klientit, duke konsideruar se ceshtjet me te detajuara te ketyre marredhenieve do te rregullohen ne kontraten qe lidhet mes brokerit dhe klientit mbi bazen e kontrates - tip, qe paraqet brokeri gjate procedures se licensimit.

2. Aktiviteti i Licensimit

Nje nga funksionet e rendesishme te Komisionit te Letrave me Vlere eshte licensimi i subjekteve qe operojne ne tregun e letrave me vlere.

2.1 Licensimi i Subjekteve

Gjate vitit 2003, prane Komisionit te Letrave me Vlere, kane paraqitur kerkesen e tyre per licensim dhe jane licensuar **10** subjekte nga te cilat:

- Banka **6**
- Shoqeri sigurimesh **1**(INSIG-un)
- Shoqeri anonime private **3** te krijuara me objekt "blerje, shitje, administrim te letrave me vlere si dhe veprime te tjera qe ndihmojne ne kete aktivitet sipas Ligjit nr.8080, date 01.03.1996 "Per Letrat me Vlere", ndryshuar me Ligjin Nr.8168, date 05.12.1996 dhe me Ligjin Nr.8745, date 22.02.2001.

Gjithashtu kane patur license per te ushtruar aktivitetin e tyre si tregetare te licensuar edhe **2** banka te tjera qe e kane marre licensen pa afat.
Si perfundim numri i subjekteve qe kane patur license per te ushtruar veprimtarine e tregetarit te letrave me vlere ne burse gjate vitit 2003 ka qene **12** subjekte.

Tabela e meposhtme paraqet sipas viteve, numrin e subjekteve dhe perfaqesuesve te tyre te licensuar per here te pare dhe rinovimin e licensave ne bono thesari:

Vitet	Aplikime te reja	Licensa te reja te dhena	Rinovim licensash	Nr. total i licensave te dhena	Nr. total i perf te licensuar
1996	7	6	-	6	9
1997	3	1	6	7	14
1998	3	2	4	6	14
1999	2	2	5	7	12
2000	2	2	6	8	12
2001	1	1	-	1	2
2002	2	1	8	9	15
2003	2	2	8	10	18

Gjate vitit 2003 Komisioni miratoi kerkesen për license ne Bono Thesari ne Burse te 2 subjekteve qe aplikuan për here te pare:

- Banka "Credins" (banka e pare private shqiptare)
- Action Capital (shoqeri anonime jo banke);

Gjate ketij viti Komisioni ka rinovuar licensen si tregtar per Bono thesari, per 8 subjektet bankare dhe institucione jo bankare te meposhtme. Gjithashtu jane licensuar edhe perfaqesuesit e tyre ne burse:

- Banka Kombetare Tregtare;
- Banka e Kursimeve;
- Banka Amerikane e Shqiperise;
- Banka Italo-Shqiptare;
- Alpha Bank;
- INSIG (shoqeri sigurimesh);
- Triumf Grup (shoqeri anonime jo banke);
- Ballkan Group-01(shoqeri anonime jo banke);

Kane patur license te vlefshme gjithashtu dhe dy banka te tjera te cilat kane patur licensa pa afat:

- Tirana Bank
- Pro Credit Bank (ish FEFAD)

Pjesa me e madhe e ketyre subjekteve u licensuan pas hyrjes ne fuqi te Regullores se Komisionit Nr.2/2, date 07.02.2003 "Mbi licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesit te tij", sipas procedurave te percaktuara ne kete Regullore.

2.2 Licensimi i Tregut

Me 1 korrik 2003 Komisioni duke ushtruar autoritetin qe i jep ligji Nr.8080 "Per Letrat me Vlere", dhe ne mbeshtetje te Regullores se Komisionit Nr. 6/1, date 17.06.2002 "Per licensimin e tregut te letrave me vlere" miratoi dhenien e licenses perfundimtare Burses se Tiranes sh.a. per te operuar si treg letrash me vlere për nje afat dyvjecar me te drejte rinovimi. Kjo ngjarje eshte nje hap shume i rendesishem drejt zhvillimit te tregut te kapitaleve ne Shqiperi duke i dhene me shume alternativa investitoreve shqiptare dhe shtruar sfida te reja perpara sektorit financiar ne vend.

2.3 Monitorimi i Burses se Tiranes sh.a

Ne zbatim te Rregullores nr.6/1 date 17.06.2002 "Per licensimin e tregut te letrave me vlere", mbi detyrimin per raportim periodik prane Komisionit te Letrave me Vlere, Drejtori i Burses se Tiranes sh.a. ka raportuar cdo muaj sipas problematikes se meposhtme:

- zhvillime te bazes rregullative dhe proceduriale;
- informim mbi ecurine e zhvillimit te aktivitetit te tregtimit dhe te elementeve te tij mbeshtetes;

- zhvillime te manaxhimit dhe administrimit;
- zhvillime ne lidhje me marredheniet e institucioneve te vendit dhe te huaja
- ceshtje te tjera, qe konsiderohen te rendesishme nga Bursa Tiranes sh.a.

Komisioni ka analizuar cdo tremujor problemet qe lidhen me veshtiresite e funksionimit real te Burses, duke kerkuar raportim te hollesishem nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres dhe Drejtori Ekzekutiv.

2.4 Monitorimi i Qendres per Regjistrimin e Aksioneve sh.a

Procesi i monitorimit eshte shtrire edhe mbi aktivitetin e Qendres se Regjistrimit te Aksioneve (QRA), te licensuar nga KLV ne Nentor te vitit 2002, per kryerjen e aktivitetit "Rregjistrues i aksioneve te shoqerive tregtare". QRA eshte e vetmja shoqeri e licensuar per kete aktivitet.
Ne fund te dhjetorit 2003 rezultojne te regjistruara ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve 64 shoqeri anonime. Numri i aksioneve te transferuara per periudhen vjetore (te reflektuara ne regjistrat e aksioneve te shoqerive te mesiperme) eshte 652.304 aksione. Ndersa numri i transaksioneve te reflektuara ne regjistrat e aksioneve gjate periudhes se mesiperme eshte 937, me nje rritje te lehte ndaj transaksioneve te kryera gjate vitit 2002 (903 transaksione). Keto transaksione jane kryer ndermjet shitesit dhe bleresit jashte tregut dhe pa sherbimin operatoreve te tregut.

2.5 Monitorimi i subjekteve te liçensuara

Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2003 kane funksionuar te pajisur me liçensa si *"Tregtare ne Burse"* 8 banka te nivelit te dyte, 1 kompani sigurimesh (INSIG) dhe dhe tre shoqeri anonime jo banka. KLV ka ndertuar dhe zbatuar proceduren e raportimit te subjekteve te licensuar ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne ankandin dhe tregtimin e bonove te thesarit. Kjo procedure mbeshtetet ne detyrimin per raportim te subjekteve, sipas nje formati te percaktuar nga KLV. Subjektet e licensuar i jane pergjigjur sipas afateve dhe sipas standartit te kerkeses per raportim
Nga te dhenat e marra rezulton qe tregtaret e liçensuar (Bankat dhe INSIG) gjate periudhes Janar-Dhjetor 2003 kane marre pjese dhe kane qene aktive ne tregun e letrave me vlere te borxhit te emetuara nga Ministria e Financave ne emer te Qeverise. Ato kane marre pjese 422 here ne ankandet e zhvilluara, duke investuar asetet e tyre. Gjendja e investimit ne portofolin e bonove te thesarit ne fund te vitit 2003 eshte 198,8 miliarde leke, me nje rritje ndaj fundit te vitit 2002 ku rezultonin rreth 180,8 miliarde leke per ndermjetesit e licensuar nga KLV (sipas te dhenave te marra nga Bankat e licensuara).

2.6 Disiplinimi

Ne prill 2003, u shpall vendimi i Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane mbi ceshtjen gjyqesore te ngritur nga Komisioni i Letrave me Vlere ndaj shoqerise tregtare "Leil-K" sh.p.k per aktivitet te palicensuar per mbajtje regjistri te aksioneve te shoqerive anonime.

Gjykata pranoi pjeserisht padine e ngritur nga Komisioni, duke vendosur prishjen me nenvizim te shteses se objektit te veprimtarise te shoqerise "Leil-K" sh.p.k per mbajtje regjistri aksionesh, dhe nuk pranoi pjesen tjeter te padise per gjobitjen me 50.000 leke te kesaj shoqerie. Ne keto kushte, Komisioni paraqiti kerkesen ankimore prane Gjykates se Apelit per ankimin e Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare per pjesen e mospranimit te padise.

3. Bashkepunimi Nderkombetar

Komisioni, gjate vitit 2003 ka vazhduar punen e tij ne drejtim te forcimit te marredhenieve me institucionet nderkombetare te tregjeve te kapitalit me qellim lehtesimin e shkembimit te informacionit si dhe mbrojtjes se investimeve.
Gjate ketij viti bashkerendimi i punes se Komisionit me autoritete te ngjashme te tregut te kapitalit ne bote, i ka sherbyer nxitjes se bashkepunimit për standartet nderkombetare dhe procedurat e tregjeve te kapitalit ne bote.

3.1 Bashkepunimi me IOSCOn

KLV qe prej vitit 1998 eshte anetar i IOSCOs (Organizates Nderkombetare te Komisioneve te Letrave me Vlere) dhe anetar i Komitetit te Tregjeve ne Zhvillim (KTZh) te kesaj organizate. Kjo organizate perbehet nga institucione qe mbikqyrin tregjet e kapitalit ne bote.
Gjate vitit 2003, Komisioni ka vazhduar bashkepunimin e tij me IOSCOn si pjese e strukturave te tij ne lidhje me probleme te ndryshme.
KLV gjate ketij viti ka bashkepunuar me IOSCOn lidhur me plotesimin e pyetesoreve te ndryshem qe synojne standartizimin e legjislacioneve midis vendeve te ndryshme anetare. Keshtu, prane Grupit te punes nr.1 te KTZH eshte derguar Pyetesori i plotesuar nga KLV mbi Kontabilitetin dhe Disiplinimin. Ne Korrik 2003 jane derguar prane IOSCOs pyetesoret e plotesuar mbi Tregun Sekondar dhe Ndermjetesit e Tregut. Gjate ketij viti ka filluar puna për pyetesorin lidhur me Marreveshjen Multilaterale te IOSCOs.
Ne Tetor 2003, KLV mori pjese ne Konferencen e 28 Vjetore te IOSCO-s qe u zhvillua ne Seul, Kore e Jugut. Ne kete Konference u mblodhen rregullatore, pjesemarres tregu dhe te tjere për te diskutuar mbi "Sfida te reja për tregjet dhe rregullatoret e letrave me vlere". Gjate trajtimit te kesaj teme u theksua se me rritjen e nder-lidhjeve te tregjeve globale financiare dhe te sfidave për rregullatoret financiare, bashkeveprimi nderkombetar duhet t'i adresohet kerkeses për permiresimin e besueshmerise se investitoreve dhe punes për stabilitetin financiar ne te ardhmen. Komisioni mori pjese ne mbledhjet e Komiteteve te kesaj organizate, ku u raportua nga grupet e punes se tyre ne lidhje me ceshtje te ndryshme qe trajtonin probleme me te cilat perballen rregullatoret neper bote.

3.2 Bashkepunimi me Komisionet Analoge dhe me Institucionet e tjera

Gjate ketij viti KLV ka shkembyer vizita pune me Autoritete te ngjashme ne bote. Keto vizita pune i kane sherbyer shkembimit te eksperiences dhe rrahjes se mendimeve me keto Autoritete për ceshtje te ndryshme ne lidhje me zhvillimin e tregut te kapitaleve.

Ne Shkurt 2003 nje delegacion nga KLV zhvilloi nje vizite pune prane Komisionit te Letrave me Vlere dhe Burses se Maqedonise. Për realizimin e kesaj vizite pune, KLV u mbeshtet financiarisht nga GTZ. Gjate kesaj vizite u zhvilluan takime me titullare te Komisionit te Letrave me Vlere dhe Burses, Ministrine e Financave dhe Banken Qendrore, me Rregjistrin Qendror dhe shtepi brokerimi te Maqedonise. Keto takime i sherbyen marrjes se eksperiences ne organizimin e tregut te kapitaleve dhe kuadrit rregullator maqedonas si dhe marrjes se informacionit mbi procesin e licensimit dhe monitorimit te subjekteve.

Ne Shtator 2003 nje delegacion nga KLV zhvilloi nje vizite pune prane Bordit te Kapitaleve te Turqise ne Ankara si dhe ne Bursen e Stambollit. Gjate kesaj vizite u zhvilluan takime me titullare te ketyre institucioneve te tregut te kapitaleve te Turqise. Keto takime i sherbyen shkembimit te eksperiences ne lidhje me procedurat e ofertes publike si dhe identifikimit te mundesive për bashkepunim ne kuadrin e trainimit te specialisteve shqiptare ne fushen e tregut te kapitaleve.

Gjate takimit me kryetarin e Bordit te Kapitaleve te Turqise Z. Dogan Canzislar, u nenshkrua Memorandumi i Mirekuptimit midis ketij institucioni dhe Komisionit te Letrave me Vlere te Shqiperise

Keto vizita ishin mjaft te rendesishme ne identifikimin e mundesive për bashkeveprim, shkembim eksperience nga pikepamja e zhvillimeve legjislative dhe proceduriale me vendet e tjera.

Ne kuadrin e bashkepunimit me institucione te tjera brenda vendit, dhe mbi bazen e marreveshjes se Mirekuptimit te nenshkruar me Fakultetin Ekonomik te Universitetit te Tiranes KLV ka ndihmuar nepermjet dhenies se leksioneve ne rritjen e nivelit te njohurive studenteve dhe pergatitjen e temave studimore nga ana e tyre per çeshtje qe kane te bejne me tregjet e letrave me vlere dhe menyrat e investimit ne keto tregje.

Gjate ketij viti eshte mbajtur nje komunikim i rregullt me institucionet e shtetit shqiptar dhe me komisionet analoge për probleme te ndryshme.

Ne kuadrin e marredhenieve me organizatat e ndryshme nderkombetare gjate vitit 2003 eshte punuar për plotesimin e pyetesoreve te meposhtem:

- Eshte plotesuar pyetesori i Derguar nga Botuesi i Revistes Global Directory te Rregullatoreve te Sherbimeve Financiare.

- Eshte plotesuar dhe derguar pergjigja e nje anketimi te kryer nga Instituti g17 për licensimin e individeve qe aplikojne për license për tregtare ne Burse

- Eshte plotesuar pyetesori i derguar nga OECD për vleresimin e efektivitetit dhe impaktin e tryezave te Rrumbullakta qe jane bere mbi qeverisjen e Shoqerive Aksionere gjate koheve te fundit.

- Eshte bere updatimi i informacionit dhene agjensise se publikimeve central Banking ublications për direktorine "Si vendet e ndryshme mbikqyrin Bankat, Shoqerite e Sigurimeve dhe Tregjet e Letrave me vlere".

- Eshte derguar pyetesori i plotesuar nga Central Banking Publication lidhur me informacionin rreth KLV, informacion i cili se bashku me ate te Autoriteteve te tjera rregullatore neper bote do te publikohet.

3.3 Marreveshjet e Mirekuptimit

Gjate vitit 2003 Komisioni i Letrave me Vlere i Shqiperise ka vazhduar punen për forcimin e lidhjeve te tij me autoritetet aktiviteti i te cilave eshte i lidhur me tregjet e kapitaleve ne bote, duke nxitur ne kete menyre koordinimin, shkembimin e informacionit dhe rritjen e integrimit.
Gjate ketij viti jane nenshkruar tre Marreveshje Mirekuptimi me autoritete rregullatore te tregut te kapitalit. Dy nga keto Marreveshje jane nenshkruar me ane te shkembimit te letrave. Me 21 Korrik 2003 u nenshkrua Marreveshja me Komisionin Polak te Letrave me Vlere dhe Burses dhe ne Dhjetor 2003 me Komisionin Bullgar te Mbikqyrjes se Tregut Financiar.
Ne Shtator 2003 nje grup nga KLV zhvilloi nje vizite pune prane Bordit te Kapitaleve te Turqise. Gjate kesaj vizite pune, me 16 Shtator 2003, u nenshkrua edhe Marreveshja e Mirekuptimit për te cilen kishin bashkepunuar kolege te te dy autoriteteve.
Gjate ketij viti eshte punuar dhe jane bere ndryshime mbi draftin e Marreveshjes se Mirekuptimit qe pritet te nenshkruhet me Komisionin Maqedon te Letrave me Vlere gjate vitit te ardhshem.
Ne kuadrin e lidhjeve te Marreveshjeve te Mirekuptimit me institucione brenda vendit, ne 6 Qershor 2003, u nenshkrua me IEKA (Institutin e Eksperteve Kontabel te Autorizuar) nje Marreveshje e tille.

3.4 Asistenca Teknike

KLV ne vijim te punes se saj për forcimin e lidhjeve me institucione dhe organizata nderkombetare i ka kushtuar rendesi te vecante identifikimit te mundesive për bashkeveprim. Gjate ketij viti jane pergatitur materiale informuese për USAID, DFID, GTZ, Banka Boterore ku pasqyrohen nevojat e tregut te kapitaleve ne Shqiperi ne kuadrin e Licensimit te Tregut te Letrave me Vlere ne Shqiperi.
Ne bashkepunim dhe me ndihmen e GTZ u realizua vizita e nje grupi pune te KLV prane Komisionit Maqedon te Letrave me Vlere ne Shkurt 2003.

3.5 Pjesemarrja e KLV ne Seminare, Konferenca e Programe Trainimi

Gjate vitit 2003 eshte punuar ne vazhdimesi për ndjekjen dhe koordinimin e programeve te trainimit. Stafi i KLV ka marre pjese ne aktivitetet e meposhtme te organizuara nga institucione dhe organizata nderkombetare ne lidhje me tregjet e kapitaleve ne bote:

- Ne Mars 2003, KLV mori pjese ne tryezen e katert organizuar mbi "Qeverisjen e Shoqerive Aksionere", organizuar nga OECD ne Bosnje-Hercegovine;

- Ne Prill 2003, KLV mori pjese ne konferencen "E ardhmja e tregjeve te kapitalit ne vendet e zhvilluara", organizuar ne Washington, SHBA;

- Ne Maj 2003, KLV mori pjese ne konferencen "Ngritja e Tregjeve te Huase" ne Budapest;

- Ne Shtator 2003, SEC dhe EWMI organizuan ne Estoni seminarin me teme "Dhenien e Informacionit dhe Qeverisjen e Shoqerive Aksionere", ku mori pjese dhe KLV;

- Ne Shtator 2003, KLV mori pjese ne trainimin mbi "Rregullimin ligjor te brokerave dhe dealerave ne Europen Juglindore", organizuar nga SEC ne Malin e Zi;

- Ne Tetor 2003, KLV mori pjese ne Konferencen Vjetore te IOSCOs ne Seul te Korese se Jugut

- Ne Nentor 2003, KLV mori pjese ne programin e trainimit te IOSCOs ne Spanje;

- Ne Dhjetor 2003, KLV mori pjese ne "Seminarin Vjetor Nderkombetar te FSA" ne Londer.

3.6 Aktiviteti Publikues

KLV ka vazhduar te publikoje gjate ketij viti "Periodikun KLV" qe ka dale rregullisht cdo tre muaj ne shqip dhe ne anglisht. Ky Botim ka dhene nje informacion te dobishem mbi veprimtarine e Komisionit dhe mbi zhvillimin e tregut te kapitaleve.

Temat kryesore te periodikut për vitin 2003 kane konsistuar ne:

- *Janar 2003* Roli i CESR ne zbatimin e legjislacionit ne tregjet europiane te letrave me vlere

- *Prill 2003* Investitori, Tregu dhe Tregtari

- *Korrik 2003* Sfidat e Tregut te integruar te sherbimeve financiare ne Europe

-*Tetor 2003* Direktivat e KE mbi marrjen e paketes kontrolluese

Gjate ketij viti, KLV sipas detyres se ngarkuar me ligj ka publikuar Raportin Vjetor 2002.
Gjate ketij viti eshte pergatitur për shtyp dhe eshte botuar Komentari "Tregu dhe Tregtaret e licensuar te Letrave me Vlere".
Gjate ketij viti eshte pergatitur dhe shperndare CD, e cila permban bazen rregullative te letrave me vlere, disa nga publikimet e viteve te meparshme ne forme broshure, raporti vjetor 2002, parimet e objektivat e IOSCOs.
Keto botime, kane synuar te pasqyrojne punen e Komisionit ne drejtim te ngritjes se nje baze ligjore bashkekohore si autoritet i vetem rregullator i tregut te letrave me vlere ne vend, bazuar ne parimet e IOSCO-s dhe Direktivat e Europes qe kane si qellimin me te larte mbrojtjen e investitoreve, parandalimin e mbi-rregullimit dhe terheqjen e pjesemarresve ne treg.

4. Zhvillimi i Tregut gjate vitit 2003

Ekonomia shqiptare, si nje ekonomi ne rritje dhe me burime te kufizuara financimi, ne stadin aktual te zbatimit te nje programi ambicioz makroekonomik dhe privatizimi te potencialeve strategjike te saj, ka nevoje te zhvilloje tregun e letrave me vlere.

Bursa e Tiranes u krijua me 2 Maj 1996, si Departament i Bankes se Shqiperise, per tu shkeputur prej saj si institucion me vete pas nje periudhe tranzitore. Fillimisht, ne kete treg u menduan te tregtoheshin instrumenta te ndryshme te tregut te kapitaleve dhe atij te parase si aksionet e shoqerive te ndryshme, bonot e thesarit, obligacionet etj. Ne vitet e para, kjo burse pati nje nivel relativisht te kenaqshem transaksionesh, kryesisht ne bono thesari dhe ne obligacione te emetuara nga qeveria. Qe nga Gushti i vitit 1998, BT iu hoq edhe kryerja e ankandeve për emetimin e bonove te thesarit ne tregun primar.

Me 1 Korrik, 2003 Komisioni i Letrave me Vlere si autoriteti i vetem rregullator i tregut te kapitaleve ne Shqiperi, bazuar ne Ligjin nr. 8080 "Për Letrat me Vlere" miratoi dhenien e licenses si "Treg Letrash me Vlere" Burses se Tiranes sh.a për nje afat dyvjecar e me te drejte rinovimi te licenses. Mbi bazen e kesaj License Bursa e Tiranes sh.a lejohet te operoje si treg i letrave me vlere bazuar ne kuadrin ligjor te siperpermendur.

Dhenia e Licences perfundimtare Burses se Tiranes sh.a i pergjigjet nivelit te zhvillimit aktual te ekonomise shqiptare, nevojes per krijimin e nje tregu legal per shkembimin e instrumentave te ndryshem te parase dhe kapitalit, duke u mbeshtetur ne pervojen e vendeve te zhvilluara te ekonomise se tregut.

Viti 2002 shenoi nje kthese ne zhvillimin e tregut te kapitaleve ne Shqiperi. Ne Mars 2002, Bursa e Tiranes u regjistrua si shoqeri aksionere ne Gjykaten e Rrethit te Tiranes me aksioner te vetem shtetin duke u shkeputur nga Banka Qendrore. Ne Nentor 2002, mbeshtetur ne Rregulloren "Per Licensimin e Tregut te Letrave me Vlere", Komisioni aprovoi dhenien e Licenses provizore BT, license e cila do t'i hapte rrugen ndjekjes se procedurave te metejshem per marrjen e licenses perfundimtare dhe ushtrimit te aktivitetit si treg i letrave me vlere.

Dhenia e licenses perfundimtare Burses se Tiranes sh.a eshte hap i metejshem ne zhvillimin e tregut te kapitaleve ne Shqiperi, eshte rritje e mundesive për investitoret shqiptare dhe pikenisje për krijimin e institucioneve te tjera te sektorit financiar.

Pas dhenies se Licenses perfundimtare, Burses se Tiranes sh.a iu akordua nje projekt i Bankes Boterore "Për Asistencen e Burses se Tiranes", projekt i cili do te kryhej nga firma konsulente angleze GMA Capital Markets Limited (GMA). Projekti, mbeshtetur ne programin e hartuar nga ekspertet e GMA konsiston ne hartimin e strategjise se zhvillimit te Burses se Tiranes nepermjet pergatitjes se nje plani strategjik për zhvillimin e saj, perfshire ketu edhe nje plan financiar për vete Bursen e Tiranes. Kjo strategji do te reflektoje nje organizim sipas standarteve nderkombetare, duke siguruar te gjitha funksionet e nevojshme. Gjithashtu objektiv i ketij projekti do te jete zhvillimi i aftesive dhe teknikave operuese te kerkuara me qellim qe ky organizim te zbatoje strategjine e miratuar. Plani strategjik do te bazohet ne nje vleresim te qarte te objektivave për zhvillimin e tregut te kapitaleve ne Shqiperi. Ky projekt do te perfundoje ne vitin 2004.

Fillimi I aktivitetit ne Bursen e Tiranes sh.a do te kete veshtiresite e veta. Veshtiresite lidhen me edukimin e shoqerive tregtare lidhur me rregullat dhe kerkesat e listimit dhe tregtimit, me kerkesat per transparence dhe informim te vazhdueshem, aplikimin e standarteve te kontabilitetit, dhe angazhimin sa me te mire te te gjitha paleve te interesuara.

Burses se Tiranes sh. a vazhdon t'i mungoje produkti baze. Deri ne fund te vitit 2003, nuk ka patur oferte letrash me vlere, gje e cila eshte nje problem i rendesishem për zhvillimin e tregut te kapitaleve ne pergjithesi dhe për tregun e letrave me vlere ne vecanti. Shqetesimet e emetuesve te letrave me vlere qendrojne ne faktin se pa nje treg te organizuar mire dhe qe te demonstroje kapacitetet e tij operacionale ata hezitojen te ndermarrin riskun e emetimit te letrave me vlere te borxhit dhe te pronesise. Sipas raportit fillestar te konsulenteve te GMA do te duhet nje angazhim i qarte nga ana e Qeverise për zhvillimin e tregut te kapitaleve. Keshtu nje rol te rendesishem duhet te luaje Qeveria ne sigurimin e paketes se pare te letrave me vlere për te nxitur fillimin e tregtimit ne tregun e letrave me vlere, duke provuar ne kete menyre edhe kapacitetin operacional te BT sh.a dhe ne te njejten kohe duke rritur besimin e investitoreve.

5. Plani i Aktiviteteve te KLV gjate 2004

Drejtimet kryesore te punes se KLV gjate vitit 2004 do te jene si me poshte:

- Plotesimi dhe permiresimi i legjislacionit mbi veprimtarine investuese ne letrat me vlere. Do te punohet per permiresimin e ligjit per letrat me vlre ne funksion te kerkesave te shtruara nga zhvillimi institucional dhe ekonomik, shoqeruar me permiresimin e vazhdueshem te akteve nenligjore te ligjit “Per Letrat me Vlere”. Do te vazhdoje puna për miratimin ne KLV dhe ndjekjen per miratim ne Kuvendin e Shqiperise te projekt ligjit te ripunuar "Mbi Investimet Kolektive ne Fondet e Letrave me Vlere"dhe akteve nenligjore te tij.

- Ndjekja e strategjise se zhvillimit te tregut te kapitaleve ne Shqiperi. Me aprovimin nga KLV te dhenies se Licenses perfundimtare Burses se Tiranes sh.a, Komisioni do te punoje per ndjekjen e procedurave te licensimit te subjekteve, per permiresimin e metejshem te procedurave te oferets publike, procesin e monitorimit te tregtimit etj.

- Nje vemendje e vecante do te vazhdoje t’i kushtohet punes ne sektorin e marredhenieve nderkombetare. Do te vazhdohet puna ne drejtim te bashkepunimit me IOSCO-n, ne drejtim te zbatimit te parimeve te kesaj organizate, te pergatitjes per nenshkrim te Marreveshjes Multilaterale te Mirekuptimit, te ndjekjes se aktiviteteve te saj si dhe informacionit, rezolutave e dokumentave qe dalin nga kjo organizate. Gjithashtu do te vazhdoje puna ne drejtim te bashkepunimit me Grupin Konsultativ, Iniciativen e vendeve te Europes Juglindore si dhe do te punohet ne drejtim te nenshkrimit te Marreveshjeve te Mirekuptimit me rregullatore te tjere te tregjeve te kapitalit.

- Gjithashtu do te punohet per pergatitjen e materialeve informuese qe synojne ndihmesen ne zgjerimin e njohurive te investitoreve ne percaktimin e synimeve te investimit dhe parashikimin e te ardhmes prej tyre.

6. Buxheti i KLV ne vitin 2003

KLV ne mbeshtetje te ligjit Nr.8080, Dt. 01.03.1996, "Per Letrat me Vlere", neni 13, financohet nga Buxheti i Shtetit me subvencion për një periudhë kohe derisa të funksionojë si institucion i pavarur ku pagimi i kuotave apo detyrimeve të tjera ndaj Komisionit do të jenë të mjaftueshme për funksionimin e tij.

Për vitin 2003, financimi nga Buxheti i Shtetit ka qene si me poshte:

BURIMET BUXHETORE DHE PERDORIMI I TYRE

	Plani	Fakti
Subvencion per funksionimin	22,000,000	21,770,663
Financim nga buxheti per investime	2,000,000	282,413
Totali	24,000,000	**22,053,076**

Ne zbatim te ligjit "Për Letrat me Vlere" neni 30 paragrafi 1, dhe kuotat e komisioneve te caktuara ne rregulloren 2/2 date 7.2.2003 "Mbi Licensimin e tregtarit te letrave me vlere dhe perfaqesuesve te tij", Rregulloren nr.9/1 date 30.10.2001 "Mbi licensimin e rregjistruesve te letrave me vlere" dhe rregulloren nr. 6/1 date 17.06.2002 "Mbi licensimin e tregut te letrave me vlere", gjendja e te ardhurave te siguruara nga kuotat e licensimit dhe shpenzimet e bera prej tyre jane si me poshte:

FONDET E VETA

Te ardhurat ne 2003	1.300,650
Te ardhura te trasheguara	199,600
Totali i te ardhurave	**1 ,500,250**
Shpenzuar nga te ardhurat	844,662
Teprica ne mbyllje	**655,588**

Komisioni harton bilancin kontabel konform Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.248 date 10/04/1998 "Per Miratimin e Planit Kontabel Publik te Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetrore Qendrore e Lokale e Njesive qe varen prej Tyre" si dhe

Udhezimit Nr.19 date 24/12/2003 te Ministrise Financave "Per pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore te institucioneve Qendrore".

Bilanci kontabel me 31.12.2003 paraqitet si me poshte:

	AKTIVI	**Ne leke**
A	Aktive te Qendrueshme	5.890.159
-	Aktive te qendrueshme te trupezuara	5.890.159
B	Aktive Qarkulluese	2.782.913
-	Gjendja e Inventarit	703.883
-	Kerkesa Arketimi mbi Debitoret	1.325.184
-	Disponibilitete	753.846
	TOTALI I AKTIVIT	**8.673.072**
	PASIVI	
A	Fonde te veta	6.639.379
B	Detyrime Afatshkurter	1.372.974
C	Rezultati ushtrimor	660.719
	TOTALI PASIVIT	**8.673.072**

SHTOJCA*

Yieldi i Bonove te Thesarit krahasuar me normen e depozitave dhe Inflacionin për vitin 2003

3 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	11.6	8.0	3.23
Shkurt	11.0	8.0	4.16
Mars	10.5	7.8	3.64
Prill	10.3	7.7	3.28
Maj	8.4	7.0	3.13
Qershor	8.2	6.8	3.03
Korrik	7.7	6.2	2.91
Gusht	7.7	6.2	2.7
Shtator	7.2	6.2	2.47
Tetor	7.6	6.2	2.22
Nent	7.5	5.5	2.22
Dhjetor	7.3	5.5	2.33



6 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	12.1	8.8	3.23
Shkurt	11.8	8.7	4.16
Mars	11.5	8.8	3.64
Prill	11.5	8.8	3.28
Maj	10.2	8.3	3.13
Qershor	9.9	7.8	3.03
Korrik	9.6	7.6	2.91
Gusht	9.6	7.6	2.7
Shtator	9.4	7.5	2.47
Tetor	9.2	7.5	2.22
Nentor	8.9	7.1	2.22
Dhjetor	8.8	7.1	2.33



12 mujore			
	B.TH	Depozita	inflacioni
Janar	13.0	9.3	3.23
Shkurt	12.4	9.2	4.16
Mars	12.1	9.2	3.64
Prill	11.6	9.2	3.28
Maj	11.4	8.8	3.13
Qershor	10.2	8.3	3.03
Korrik	10.1	7.9	2.91
Gusht	10.2	7.9	2.7
Shtator	10.1	7.8	2.47
Tetor	10.0	7.8	2.22
Nentor	9.6	7.6	2.22
Dhjetor	9.6	7.6	2.33



- te dhenat per shtojcen: Banka e Shqiperise

Yieldi per Bonot e Thesarit 2003			
Ne perqindje			
	3 mujore	6 mujore	12 mujor
Janar	11.6	12.1	13.0
Shkurt	11.0	11.8	12.4
Mars	10.5	11.5	12.1
Prill	10.3	11.5	11.6
Maj	8.4	10.2	11.4
Qershor	8.2	9.9	10.2
Korrik	7.7	9.6	10.1
Gusht	7.7	9.6	10.2
Shtator	7.2	9.4	10.1
Tetor	7.6	9.2	10.0
Nentor	7.5	8.9	9.6
Dhjetor	7.3	8.8	9.6



Vlera nominale e pranuar ne ankand per BTH (mln leke)			
	3 mujor	6 mujor	12 mujor
Janar	25096.30	17516.00	13802.00
Shkurt	17846.00	13947.40	10198.40
Mars	13872.40	13900.00	15400.00
Pril l	19200.00	13000.00	11200.00
Maj	18277.80	16148.40	20000.00
Qershor	14100.00	12000.00	14000.00
Korrik	20800.00	16200.00	17300.00
Gusht	20800.00	11377.00	17300.00
Shtator	14206.40	13464.80	10395.20
Tetor	20491.90	17561.70	15783.00
Nentor	15500.00	10400.00	10500.00
Dhjetor	15659.60	12000.00	14700.00

Burimi: Banka e Shqiperise

Treguesit Ekonomike

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Prodhimi dhe Shpenzimet	*(ndryshimi ne perqindje)*											
Rritja e PPB	-7.2	10.0	8.3	13.3	9.1	-10.3	12.70	8.8	7.7	7.6	4.70	6
Prodhimi industrial	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4	5	6.5	2.0	3
Prodhimi bujqesor	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	3.7	4.5	1.4	2.1	2.7
Ndertimi	7.0	30.0	15.0	21.08	18	-6.3	21	15.0	17.0	14	9.1	11.3
Transporti	-15.0	-13.0	18.0	19.0	-1.0	-20.5	20.0	15.0	14.0	13	10.1	10.3
IÇK(1Ndryshimi 12 mujor ne %)	236.6	31.0	16.0	6.0	17.4	42.0	8.7	-1	4.2	3.5	1.7	3.3
Pagat mesatare mujore (sektori publik) (000 leke)	NA	3084	4778	6046	8638	9558	11509	12708	1489	17218	19574	
Paraja gjithsej-M3 (fundi i vitit) (mln leke)	28771	50355	70775	107449	154552	198547	239526	292871	328101	394316	416685	448427
Paraja jashte bankave (mln leke)	9897	17990	27627	41906	47815	72726	68323	81336	99236	119091	130776	125191
	(Ne milione leke)											
Kreditit i brendshem	31773	80248	94525	85112	126063	180305	207937	230554	247178	266479	295081	320755
Pretendime ndaj Qeverise	20234	73343	84839	73673	111759	164470	187814	212041	224476	238538	256432	270071
Pretendime ndaj nd. Publike jofinaciare	10164	2444	2485	3093	3414	2898	2830	1671	1053	547	33	-
Pretendime ndaj sektorit privat	1375	4462	7201	8347	10890	13007	13485	16841	22189	27394	38619	50585
	(Ne perqidnje ndaj PPB)											
Te ardhurat buxhetore	22.8	26.7	24.1	23.4	18.4	16.6	20.5	20.6	22.4	22.9	22.9	26.6
Totli i Deficitit	-58.6	-13.7	-9.0	-10.2	-12.8	-12.9	10.4	-11.0	-9.3	-8.6	-6.2	-5.7
Shpenzimet buxhetore	81.4	40.4	33.1	33.6	31.2	29.5	30.7	32.7	31.6	31.5	29.1	32.3
Borxhi i Jashtem	90.3	41.1	179.7	261.4	323.5	347.5	460.5	550.1	616.9	697.7	978.4	-
Te dhena mbi bilancin e pagesave				(ne milion USD)								
Llogaria Korente	-50.8	14.7	31.2	36.7	-62.4	-253.7	-45.2	-132.9	-163.1	-218.5	-420.8	-257.6
Transfeta Private	150.0	324.1	374.1	349.0	476.0	236.0	437.7	188.4	438.6	542.7	575	565.8
Transferta Shteterore	374.0	280.0	117.0	129.0	84.0	29.0	82.6	16.5	94.4	28.1	38.2	30
Bilanci Tregtar	-470.0	-490.0	-460.0	-475.0	-678.0	-535.0	-603.7	-662.8	-814.3	-1026.9	-1155.2	-957.6
	(Per jave importi)											
Reserva (perjshtuar arin)	3.3	12.8	4.1	4.2	3.6	5.3	5.7	5.7	29.4	28.9	18.4	
Tregues te ndryshem												
Popullsia (ne milion)	3.2	3.2	3.2	3.2	3.3	3.35	3.35	3.37	3.4	3	3.1	3.1
Papunesia (ndryshimi ne %,mesatare vjetore)	-27.8	-7.8	-6.4	0.35	-7.3	22.7	21.1	2.1	-10.5	-16		
Norma e papunesise (ne% te forces te punes)	30.3	22.3	18.4	13.0	12.4	14.9	17.8	18.2	16.8	14.6	16	
PPB (ne milion Leke)	49517	125334	184400	22979	29100	341716	480631	506205	539210	590237	658062	
Prodhimi bujqesor ne % te PPB	54.0	56.0	56.0	56.0	52.8	56.0	54.4	52.6	35.9	34.2	33.3	24.7
Prodhimi industrial ne % te PPB	17.0	14.0	13.0	11.7	12.5	12.4	11.9	11.9	13.2	13.2	12.8	10.2
Kursi kembimit (leke euro mes vjetore)								146.96	132.58	128.47	132.36	137.57
Kursi i Kembimit (Leke per USD, mes. vjetore)	75.0	102.0	94.7	92.8	104.5	148.9	150.6	137.69	143.71	143.48	140.15	121.86
Norma e interesit (huadhenia,12 m. maturimi, fundi i vitit)	39.0	30.0	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0	25.8	23.7	11.9	16.0	10.5

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Depozitat											
	(ndryshimi vjetor ne %)										
Totali i depozitave	71.5	33.3	52.7	64.5	24.8	36.2	23.6	8.2	20.3	8.0	22.1
Depozita pa afat	43.9	7	60.9	158	-49.6	-17.2	40.7	14.5	-3.9	-5.6	-16.1
Depozita me afat	145.7	59.8	49.9	21.5	110.3	60.7	183	2.8	15.5	7.2	27
Depozita ne valute	49.8	29.8	50.9	54.4	13.4	10.7	32.2	19.5	40.1	13.5	22.1
Normat e interesit											
	(fundi i periudhes, vjetore ne %)										
Perqindja e rifinancimit	…	25.0	20.5	24.0	32.0	22.9	17.8	10.8	-	- -	
Perqindjet e depozitave -12 m	…	16.5	13.7	19.1	27.8	16.5	9.1	7.7	7.8	9.3	7.6
Perqindja e Kredise - 12 m	…	20.0	21.0	28.8	43.0	25.0	25.8	23.7	11.9	16.0	10.5
Bono Thesari - 3 m	…	…	14.7	21.1	35.3	19.9	14.8	7.8	8	11.2	7.3
Bono Thesari - 6 m	…	…	14.9	22.3	34.5	21.5	15.5	11.3	9.8	12.0	8.8
Bono Thesari -12 m	…	…	15.1	22.5	35.0	23.0	15.8	12.3	10.5	12.6	9.6

Burimi: Ministria e Finances, Banka e Shqiperise, INSTAT

Republic of Albania

Albanian Securities Commission

Annual Report

2003

Table of Contents

The Main Events **29**
General Information on the Albanian Securities Commission **30**
Organization Structure of the Albanian Securities Commission **33**

1. Legislation **34**

2. Licensing, Monitoring and Enforcement **36**
2.1 Licensing of the companies 36
2.2 Licensing of the Securities Market 37
2.3 TSE's Monitoring 38
2.4 The monitoring of the Registrar 38
